

URDHËR
Nr. 230/2, datë 23.8.2012

PËR REVOKIMIN E URDHHRIT NR. 230, DATË 5.7.2012 “PËR DELEGIM KOMPETENCASH”

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 121 e në vijim, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

URDHËROJ:

1. Revokimin e urdhrit nr. 230, datë 5.7.2012 “Për delegim kompetencash”, zëvendësministri i Brendshëm, z. Ferdinand Poni, të trajtimit të korrespondencës për marrjen e mendimeve nga ministritë e linjës lidhur me projektvendimet e pronave që hartohen nga Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, në zbatim të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm në ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Flamur Noka